



Projekti: “Ndjekja dhe verifikimi i premtimeve të fushatës zgjedhore në Shqipëri”

Projekti ndihmon qytetarët shqiptarë që të gjejnë dhe rregjistrojnë premtimet elektorale të politikanëve shqiptarë. Projekti ofron mjete dhe mundësi për të verifikuar realizimin e këtyre premtimeve.

Qëllimi është që të mbahen nën përgjegjësi lidhur me premtimet deputetët e parlamentit shqiptar dhe të zgjedhurit lokalë, kryetarët e Bashkive.

Këtij qëllimi i shërben përgatitja e buxheteve qytetare, që janë versione të thjeshtuara të buxheteve bashkiake për vitin 2020. Nëpërmjet këtyre buxheteve qytetarët do të kuptojnë më mire mënyrën e shpenzimeve dhe se si shpenzohen taksat e tyre.

Ju lutemi të gjeni në këtë dokument buxhetin e thjeshtuar qytetar të Bashkisë Kolonjë.

Gjatë takimit të sotëm të këtij fokus grupi do të përpiqemi të kuptojmë se sa i thjeshtë dhe i kuptueshëm është buxheti qytetar. Ju lutemi shprehni mendimet dhe sugjerimet tuaja që të përmirësojmë këtë dokument dhe ta paraqesim përpara qytetarëve të Bashkisë Kolonjë.

Ju falenderojmë për mbështetjen dhe bashkëpunimin!

Buxheti Qytetar i Bashkisë Kolonjë, Viti 2020:

1. Analiza e parashikimit për të ardhurat për vitin fiskal 2020

Studimi ka për qëllim të analizojë parashikimin për të ardhurat e vitit 2020, e cila do të na ndihmojë të shohim se ku janë përfitimet, problematikat dhe pritshmëritë.


Bazuar në Ligjin nr. 9632, “Për sistemin e taksave vendore”, bashkitë kanë të drejtë të vendosin taksat e tyre +/- 30% nga taksa e miratuar në Ligj, ndërsa tarifatat mund të rriten, zvogëlohen, shtohen apo hiqen me miratim të Këshillit Bashkiak, sipas nevojave të Bashkisë.

Tabela 1. Të ardhurat totale të Bashkisë sipas burimeve, /000 lek

Burimet e financimit	Viti 2019	Viti 2020	Diferenca 2020-2019
Transferta e pakushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim i lirë)	-	120,195 (35%)	-
Transferta e kushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)		96,002 (28%)	-
Transferta e pakushtëzuar sektoriale (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	-	4,334 (1%)	-
Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore (të ardhurat nga detyrimet e qytetarëve kundrejt Bashkisë)	-	80,050 (23%)	-
FZHR (Grante nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve)	-	45,348 (13%)	-
Total	-	345,929	-


Burimi: Bashkia Kolonjë, 2020, llogaritje EIC

Figura 1. Të ardhurat totale, Bashkia Kolonjë 2020



Burimi: Bashkia Kolonjë, 2020, Ilogaritje EIC

Figura 2. Të ardhurat totale për vitin 2020



Burimi: Bashkia Kolonjë, 2020, Ilogaritje EIC

Më poshtë është dhënë parashikimi mbi të ardhurat nga taksat dhe tarifat, duke zbritur të ardhurat nga gjobat, insitucionet e varësisë dhe shërbimet e ofruara nga Bashkia.

Tabela 2. Të ardhurat nga taksat dhe tarifat

Njësia vendore	Të ardhurat nga taksat dhe tarifat 2020
Bashkia Kolonjë	- (të ardhurat pa gjobat dhe të ardhurat e tjera vendore)
	Të ardhurat vendore
	80,050

Burimi: Bashkia Kolonjë, 2020, llogaritje EIC

Një element tjetër i rëndësishëm për të ardhurat në buxhetin e bashkive është edhe transfertat e pakushtëzuar dhe ajo specifike, e cila ndihmon ndjeshëm njësitë vendore në përmbushjen e planeve të investimeve dhe shpenzimeve.

Tabela 3. Transfertat qeveritare (fonde të deleguara nga Qeveria për Bashkitë)

Emërtimi	2020	% mbi Tot. Ardh.
Transferta e pakushtëzuar	120,195	(35%)
Transferta e kushtëzuar	96,002	(28%)
Transferta specifike	4,334	(1%)

Burimi: Bashkia Kolonjë, 2020, llogaritje EIC

2. Analiza e shpenzimeve të Bashkisë Kolonjë për vitin fiskal 2020

E rëndësishme për qytetarët është procesi i shpërndarjes së fondeve, ose e thënë ndryshe, ku shkojnë paratë e taksapaguesve; përse shpenzohen nga bashkia?

Analiza më poshtë do marrë në konsideratë shpenzimet afatshkurtra dhe ato afatgjata për vitin 2020.


Më poshtë po japim tabelën përmbledhëse të shpenzimeve:

Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programeve dhe raporti mbi të ardhurat totale

Emërtimi i shpenzimit	Viti 2019 në 000/Lekë	Viti 2020 në 000/Lekë	Diferenca në vlerë në 000/Lekë	Diferenca në %	% mbi Tot. Ardh.
Shpenzime Paga+Sig.Shoqërore		189,446			55
Shpenzime Korrente		92,737			27
Shpenzime për Investime		63,746			18
TOTAL		345,929			100


Burimi: Bashkia Kolonjë, 2020, llogaritje EIC

Figura 3. Shpenzimeve për vitin 2020



Burimi: Bashkia Kolonjë, 2020, llogaritje EIC

Figura 4. Shpenzimet totale si raport mbi të ardhurat totale



Burimi: Bashkia Kolonjë, 2020, llogaritje EIC

Më poshtë po japim shpenzimet e Bashkisë sipas Programeve

Tabela 5. Shpenzimet sipas programeve dhe si % ndaj Tot.të ardh.vendore

Shpenzimet Bashkia Kolonjë	Vlera	% ndaj TA vendore
Programi ekzekutiv & legjislativ, çështje finaniare	62,173	18.0
Shërbime policore	6,045	1.7
Shërbimet e mbrojtjes ndaj zjarrit	13,216	3.8
Marrëdhëniet me komunitetin	6,532	1.9
Çështjet e përgjithshme ekonomike, tregëtare	1,555	0.4
Bujqësia & pyjet, peshkimi, gjuetia	50,522	14.6
Transporti	8,895	2.6
Industri të tjera	8,548	2.5
Menaxhimi i mbetjeve	19,968	5.8

Mbrojtja e mjedisit	2,039	0.6
Urbanistika	4,523	1.3
Zhvillimi i komunitetit	33,865	9.8
Ndriçimi i rrugëve	8,045	2.3
Shërbimet rekreative & sportive	5,913	1.7
Shërbimet kulturore	6,862	2.0
Arsimi bazë & parashkollor	40,124	11.6
Arsimi parauniversitar	54,094	15.6
Sëmundje & paaftësi	6,249	1.8
Të moshuarit	636	0.2
Familje & fëmijë	625	0.2
Strehimi social	500	0.1
Fondi rezervë	500	0.1
Fondi i emergjencës	3,500	1.0
Fondi i kontigjencës	1,000	0.3
Total	345,929	100.0

Burimi: Bashkia Kolonjë, 2020, llogaritje EIC